L I G J
Nr. 8581, datë 17.2.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8435, DATË 28.12.1998 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJET 8508, DATË 7.7.1999; NR.8519, DATË 30.7.1999 DHE NR.8552, DATË 18.11.1999

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet 8508, datë 7.7.1999; nr.8519, datë 30.7.1999 dhe nr.8552, datë 18.11.1999 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 shtohet pika 23 me këtë përmbajtje:
"23. Taksë e shitjes së pasurisë së luajtshme (automjetet)."

Neni 2

Në nenin 6, në pikën I "Taksat kombëtare" pas shkronjës "rr" shtohet shkronja "s" me këtë përmbajtje:
"s. Taksa e shitjes së pasurisë së luajtshme (automjetet) është në masën 2 për qind të vlerës së shitjes të pasurisë. Kjo taksë paguhet në çastin e kryerjes së aktit të shitjes.
Kjo taksë do të fillojë të zbatohet më 1 janar 2001."

Neni 3

Në neni 8, në shkronjën "A. Për taksat kombëtare", pikat 3 dhe 17 ndryshojnë, përkatësisht, si vijon:

"3. Për taksën vjetore të tonazhit të automjeteve për aks e cila ndahet:	10 për qind
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	8 për qind
- Drejtoria e Qarkullimit Rrugor, pranë Ministrisë së Rendit Publik	2 për qind"
"17. Për taksën e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve e cila ndahet:	10 për qind
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	8 për qind
- Drejtoria e Qarkullimit Rrugor, pranë Ministrisë së Rendit Publik	2 për qind"

Neni 4

Në nenin 9, në pikën "A. Për taksat kombëtare", pas shkronjës "p" shtohet shkronja "q", ndërsa shkronjat "c", "ç" dhe "e" ndryshohen si vijon:
"q. Për taksën për shitjen e pasurisë së luajtshme ngarkohen zyrat e noterisë në çastin që kryhet akti i shitjes."
"c. Për taksën vjetore të tonazhit të automjeteve për aks ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor."
"ç. Për vjeljen e taksës së regjistrimit të përvitshëm të automjeteve ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Të ardhurat nga kjo taksë përdoren, kryesisht, për

përmirësimin e sistemit të sinjalizimit rrugor.

Drejtoria e Qarkullimit Rrugor, pranë Ministrisë së Rendit Publik ndërmjet degëve të qarkullimit rrugor në rrethe bën kontrollin e vjeljes së taksës së regjistrimit të përvitshëm të automjeteve dhe të taksës së tonazhit për aks."

"e. Për taksën për pajisje me dëshmi aftësie për drejtim automjeti ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor."

Neni 5

Në lidhjen nr.2 "Taksat për shërbimet konsullore", në pikën I "Taksat për lëshimin e vizave dhe dokumenteve të udhëtimit", shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

"9. Turistët individualë ditorë, që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë paguajnë taksë vize ose taksë hyrjeje në masën 10 USD.

Nuk i nënshtrohen pagimit të kësaj takse të gjithë turistët ditorë, të organizuar në grupe."

Neni 6

Lidhjet nr.3 dhe nr.5 ndryshojnë sipas lidhjeve që i bashkëlidhen këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2567, datë 28.2.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

Lidhja nr.3

TAKSAT VJETORE TË TONAZHIT TË AUTOMJETEVE PËR AKS

Nr.	Tipi i mjetit	Masa e taksës për një aks Lekë
1.	Mikrobuz (më i vogël ose i barabartë 8+1)	5 000
2.	Furgon dhe kamion deri në 3.5 tonë	10 000
3.	Kamion mbi 3.5 deri në 7.5 tonë	15 000
4.	Kamion mbi 7.5 deri 17 tonë	18 000
5.	Kamion mbi 17 tonë	23 000
6.	Autobuz më i vogël ose i barabartë 32 +1 vende	10 000
7.	Autobuz më i vogël ose i barabartë 42 + 1 vende	13 000
8.	Autobuz më i madh mbi 42+1 vende	15 000
9.	Rimorkio deri në 7 tonë	7 500
10.	Rimorkio mbi 7 tonë	10 000

Mjetet e klasifikuara (sipas Kodit Rrugor) si makina transporti (autovinça, autobetoniera, vetëngarkuesit etj.) do të paguajnë një taksë sa dyfishi i taksës së tonazhit të automjeteve analoge me to.

Taksat e mësipërme janë vetëm për një aks. Pagesa e plotë e taksës do të jetë taksa për një aks shumëzuar me numrin e akseve.

Lidhja nr.5

TAKSAT VJETORE PËR REGJISTRIMIN E PËRVITSHËM TË AUTOMJETEVE

Tipi i mjetit	Masa e taksës Lekë
1. Motomjete	600
2. Autoveturë	2 400
3. Mikrobuz (më i vogël ose i barabartë 8 +1 vende)	4 800
4. Furgon dhe kamion deri në 3.5 tonë	3 600
5. Kamion mbi 3.6 deri në 7.5 tonë	4 800
6. Kamion mbi 7.6 deri 17 tonë	6 000
7. Kamion mbi 17	8 000
8. Autobuz (më i vogël ose i barabartë 32 +1 vende)	6 000
9. Autobuz (më i vogël ose i barabartë 42 +1 vende)	7 200
10.Autobuz më i madh 42 +1 vende	8 400
11. Autobuz artikular më i madh se 42 vende	9 000
12. Mjete për punime ndërtimi dhe toke (traktor rrugor, karkalec) më të vegjël se 7.5 tonë	3 000
13. Mjete për punime ndërtimi dhe toke (traktor me goma, fadromë, autovinç, vinç me goma) mbi 7.5 tonë	3 600